



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

nr. 4586 prot

dt. 26.04.2019

UDHËZIM

Nr. 7 datë 26.04:2019

PËR

**ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2019,
SESIONI I DYTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 50, të Ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", të ndryshuar dhe vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)",

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, për vitin shkollor 2018-2019, do të zhvillohen si më poshtë:
 - a. Gjuhë e huaj 20 gusht 2019
 - b. Gjuha shqipe 23 gusht 2019
 - c. Matematikë 28 gusht 2019
2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën "Gjuhë amtare". Provimi kombëtar i arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën gjuhë amtare, do të zhvillohet më 19 gusht 2019.
3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2019, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr.774, datë 22.11.2018, "Për miratimin e rregullores për "Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018 - 2019".

4. Provimet kombëtare të arsimit bazë 2019, sesioni i dytë, fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.
5. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren për “Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018- 2019”.
6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastrë. Në ditën e provimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar Delvinë dhe Sarandë, tërheqin tezën në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastrë.
7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë.
8. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
9. Arkivimi i testeve bëhet pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
10. Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, dhe raporton në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletore Zyrtare”.

BESA SHAHINI

MINISTËR

